



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:255871

Datë: 20.02.2024

Numri i dokumentit: 05348906

KF.nr.970/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në konfliktin administrativ të paditësit NSHP “Eurogarten” me seli ne fshatin Banullë, Komuna e Lipjanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat E.A. Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, në rigjykim-rivendosje sipas Aktvendimit K.D.SH.II. nr.227/22 të datës 06.10.2022, të Dhomave të Shkallës së Dytë të kësaj Gjykate, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e Aktvendimit nr. 96/2015 i datës 15.05.2015 të paditurës, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të paditësit E.A. avokat me autorizim, dhe në mungesë të përfaqësueses së paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me datë 07.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “NSHP “Eurogarten” me seli në fshatin Banullë Komuna e Lipjanit.
- II. ANULOHET vendimi nr. 96/2015 i datës 15.05.2015, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Dhoma e shkallës së dytë të kësaj gjykate me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 227/22 të datës 06.10.2022, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit “NSHP “Eurogarten” me seli ne fshatin Banullë Komuna e Lipjanit, e ka prishë Aktgjykimin A.nr.1101/15 të datës 15.06.2020 dhe lëndën e ka kthyer kësaj gjykate ne rigjykim dhe rivendosje.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses ne padi, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës ATK-së, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i atakuar 96/2015 i datës 15.05.2015, i të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës. Paditësi deklaron se e paditura nuk ka aplikuar drejt dispozitat ligjore mbi procedurën administrative dhe te ligjit mbi ATK, dhe nuk është vërtetuar drejte gjendja faktike dhe nga faktet qe janë shqyrtuar është marr vendim jo i drejt dhe i pabazuar. Me tej paditësi dhe përfaqësuesi i tij ne padi dhe ne seancën e shqyrtimit kryesor deklaron se fillimisht mbes ne tërësi si ne sqarimet te cilat janë paraqit gjate rrjedhës se procedurës, e njoftoj gjykatësin e çështjes se plotësim i dyte i ekspertizës financiare nga grupi i eksperteve financiar me është dorëzuar se bashku me ftesën për këtë seance dhe me shtojcën e evidencës e flete dërgesave te karburanteve për vitin 2008, andaj konsideroj se tanimë është e qarte dhe nuk kam pyetje për ekspertin dhe as vërejte ne raport me plotësimin e dyte te super ekspertizës financiare. Andaj, nga provat te cilat u shqyrtuan ne procedurën e administrimit te provave e sidomos duke u bazuar ne mendimet e eksperteve si dhe plotësimin e dyte të grupit te eksperteve, konsiderojë se vendimi kontestues i te paditurës është jo ligjor për fakte dhe arsyet te cilat janë paraqitur gjate tere rrjedhjes se procedurës si dhe mendimit te eksperteve te cilët me ekspertizat e tyre kane paraqitur mendimin e tyre me arsye te forta dhe profesionalë se paditësi është detyruar qe te paguaj TVSH-ën si dhe detyrimet te tjera fiskale me tepër se sa është përcaktuar me ligj. Nga te gjitha këto fakte te vërtetuar i propozojmë gjykatës qe: Te aprovohet padia- kërkesë padia si e bazuar , te anulohet ne tërësi vendimi kontestues i te paditurës dhe te lirohet nga obligimet tatimore përtej shumes se përcaktuar me plotësimin e dyte te super ekspertizës financiare. Shpenzimet e procedurës i kërkojë dhe atë për përpilim e padisë ne shume prej 208.00 €, për përfaqësimin ne çdo seancë te mbajtur ne shume prej 270.00 €, ndërsa për seancat e shtyra shumen prej 135.00 €, për përpilimin e ankese shumen prej 416.00 € , de pagimin e taksës gjyqësore ne shume prej 31.00 € , për pagesën eksperteve shume si ne faturat qe gjinden ne shkresat e lendes dhe për taksen gjyqësor e për padi shumen sipas vendimit te kësaj gjykate.

E paditura, përmes përfaqësueses së autorizuar Ministrisë së Drejtësisë në përgjigje në padinë, e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses. Me tej deklaron se e paditura- ATK-ja, Zyra Regjionale ne Prishtinë 3 ne zbatim te legjislacionit tatimor dhe procedurat, dhe vendimit e DA të ATK me date 19.02.2015 ka kryer ri kontroll te tatimpaguesi pe periudhat TVSH prej 01/200809/2013, TAP 2008-2012, TMB 01/2008-09/2013, KP prej 01/2008-09/2013. Kontrolli është realizuar duke u bazuar ne legjislacionit tatimor të aplikueshëm, dhe dokumentacionin e

tatimpaguesit te siguroar nga ATK-ja sipas ligjit, si rezultat i parregullsive të konstatuara me kontroll dhe mospranim te shpenzimeve te argumentuar, rezultuar tatim shtese për subjektin NSHP Eurogarten prej 236,117.20€, pa ndëshkim dhe interes dhe zbritje kreditim ne shume prej 2,826.50€. Me vendimin nr. 96/2015 dt. 15.05.2015 DA-ATK-ja e ka aprovuar pjesërisht ankesën e tatimpaguesit-paditësit dhe ndryshuar Njoftim Rivlerësimin e tatimit shtese ne TVSH 11/2010 dhe TAP 2010 lidhur me faturën e subjektit Kema Kompani ne vlere prej 58,284.49 e për subjektin NSHP Eurogarten dhe ne këtë rast e ka liruar tatimpaguesin nga qarkullimi shtesë për këtë faturë. Ne lidhjet me pretendimet e paditësit për mos pranim te shpenzimeve te artikujve dërrasa, hekur, derivate etj. Me kontroll dhe nga DA-ATK-se konstaton se nuk qëndrojnë fare për faktin ne kontroll ATK-ja i ka pranuar si shpenzime te zbritshëm sasinë dërrasave dhe hekurit mbi bazën e normativit përpunohet parapara me kontrate në tender te fituar, dhe vetëm për diferencën e blerjeve e ka ngarkuar tatimpaguesin duke i trajtuar diferencën shitje me te drejt.

Ndërsa lidhur me ekspertizë dhe super ekspertizë e paditura deklaror se e kundërshtojmë cdo raport të ekspertizës, super ekspertizës financiare dhe plotësimit të tyre që bie në kundërshtim me vendimin e ATK-së nr.96/2015. Përveç qëndrimit të përgjigjes në padi të datës 09.12.2016 dhe kundërshtimit të ekspertizës të datës 15.05.2019, ATK-ja në tërësi qëndron dhe kërkon nga gjykata që të vërtetoj vendimin e ATK-së nr.96/2015 datë 15.05.2015 duke marr aktgjykim të refuzohet padia dhe kërkesëpadija e paditësit në tërësi si e pa bazuar dhe të mbete në fuqi vendimi i ATK-së nr.96/2015 datë 15.05.2015.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ gjyqësor në pajtim me dispozitat e nenit 41 të LKA-së, për arsye se, përfaqësuesja e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me parashtresën e datës 05.02.2024 e ka njoftuar Gjykatën se nuk do të prezantojë në këtë seancë dhe ka propozuar që të veproj në pajtim me nenin 38. parag. 5 të LKA-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik, ka administruar provat relevante dhe atë: Vendimi 96/2015 i datës 15.05.2015, Flete dërgesat e karburanteve për vitin 2008 sipas evidencës se bashkangjitur ne plotësimin e dyte te super ekspertizës financiare, Pasqyrë e rrjedhës se parasë, Pasqyra e nderimeve ne ekuitet, Raporti i auditorit-ligjor i datës 07.03.2012, Bilanci i gjendjes, Bilanci i suksesit, Njoftimi vlerësimet për borgjet se bashku me strukturën e detajuar te borgjeve, Raporti i ri kontrollit i datës 19.02.2015, Përgjigja ne padi e datës 12.12.2016, Format AU001, AU002, AU003, Libri i pranimit, Intervista me tatim paguesin, Gjendja e borgjeve, Fatura nr.01221110,

2281009, 2271010, 4141009, 520909, 61910, 0150610, 229510, 417510, 122410, 726809, 23,18,16, 12, 300810, 628209, 301110-2, Libri i blerjes, Kartela e klientit, Ekspertiza financiare e datës 11.04.2019, Parashtresa e te paditurës e datës 22.05.2019, kundërshtim i pjesshëm i ekspertizës financiare, Super ekspertiza financiare e datës 13.11.2019, Librezat e veturave, DUD-at 4475/02.04.2010, 12489/03.09.2009, 578/29.01.2010, Vendimi 258/2014 i datës 01.09.2014, Parashtresa e te paditurit e datës 25.11.2019, Plotësim i super ekspertizës financiare i datës 26.02.2020, Plotësimi i dyte i super ekspertizës financiare i datës 05.01.2024, Flete dërgesat e këtu paditësi me subjektin “Kema Company”, Flete dërgesat dhe kuponët e këtu paditësit me subjektin “Standart Benz”, se bashku me tabelat e shitjeve.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave të palëve ndërgjyqëse, dhe pasi vlerësoi provat veç e veç dhe të gjitha së bashku, morri vendim sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, Gjykata nga raport kontrolli i ATK-së, deklarimeve në ankesë, si dhe aktvendimi kontestues ka nxjerr konstatimin se paditësi në bazë të Raportit të Ri-kontrollit, për periudhën prej të tatimpaguesi për periudhat TVSH prej 01/2008-09/2013, TAP 2008-2012, TMB 01/2008-09/2013, KP prej 01/2008-09/2013, dhe si rezultat i kontrollit e ka ngarkuar tatimpaguesin - paditësin me tatim shtese.

Me vendimin kontestues, e paditura Departamenti i ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës e ka aprovuar pjesërisht ankesën e tatimpaguesit paditësit dhe ndryshuar Njoftim Rivlerësimin e tatimit shtese në TVSH 11/2010 dhe TAP 2010 lidhur me faturën e subjektit “Kema Company” në vlerë prej 58,284.49€ për subjektin NSHP Eurogarten dhe në këtë rast e ka liruar tatimpaguesin nga qarkullimi shtesë për këtë faturë, Ndërsa pjesën tjetër të njoftim rivlerësimit e vërtetohet si të bazuar.

Gjykata konstaton se Dhomave të Shkallës së Dytë të kësaj gjykate, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr.227/22 të datës 06.10.2022 të Dhomave të Shkallës së Dytë të kësaj gjykate, lëndën e kanë kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje pranë kësaj gjykate me arsyetimin se duhet mënjeluar shkeljet esenciale të dispozitave kontestimore nga neni 182 parag.2 të LPK-së, që janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktgjykimit të goditur. Në ri procedurë gjykata e shkallës së parë duhet të shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga Kolegji i Dhomës së Shkallës

së Dytë, duke vepruar sipas rregullave procedurale kontestimore duke kërkuar nga palët ndërgjyqëse që gjykatës të i prezantojnë aktin administrative të kontestuar për të cilin është iniciuar konflikti administrativ.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues lidhur, si dhe pretendimet te tjera nga paditësi, është mbajtur seancë me datë 23.03.2023 dhe me propozimin e përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse se është e nevojshme që grupi i ekspertëve të bëjë shikimin e dokumentacionit origjinal të cilin e posedojnë në zyre dhe të njëjtin marrë për obligim që brenda afatit gjyqësor t'ia dorëzoj gjykatës dhe pas deponimit të këtyre faturave në origjinal të njëjtat ti përcjellën grupit të ekspertëve ashtu që ekspertiza bazë e grupit të ekspertëve e datës 13.11.2019 të kthehet në plotësim në mënyrë që grupi i ekspertëve pasi t'i shikojë këto dokumente të deklarohej nëse konstatimi dhe mendimi i tyre të ekspertëve dhe plotësim ekspertizë qëndron edhe më tutje.

Eksperti financiar A.K. në seancë ka deklaruar në emër të grupit të eksperteve se pas marrjes së dokumentacionit shtese lidhur me këtë lende gjyqësore, gjegjësisht numrit të konsiderueshëm të flete dërgesave të karburanteve grupi i eksperteve i ka trajtuar të gjitha një për një dhe me përkushtim të plote profesional dhe etike ka dhënë konstatimin dhe mendimin në faqen 9 të plotësimit të dytë të super ekspertizës sipas të cilës ka ndryshuar dukshëm vlera e obligimeve të përgjithshme tatimore të palës paditëse “Eurogarten”.

Nga plotësimi i super ekspertizës për herën e dytë është dhënë mendimi dhe konstatimi nga grupi i ekspertëve të cilët cekin se pas analizës së detajuar të gjithë dokumentacionit në dispozicion lidhur me lëndën gjyqësore, mbetja e obligimeve tatimore të N.Sh.P “Eurogarten” sipas këtij plotësimi të dytë të ekspertizës është sipas tabelës nr.6 të paraqitur në këtë plotësim të dytë dhe obligimi ndaj TVSH-së është 110,353.41 euro si dhe ndëshkim 25% prej 27,558.35 euro, e që në total është 137,941.76 euro. Ndërsa obligim ndaj Tatimit në të Ardhura TAP është 34,215.16 euro si dhe ndëshkim 25% prej 8,553.79 euro e që në total është 42,768.95 euro. Nga e gjithë kjo llogaritje gjithsejtë obligimet tatimore duke përfshirë edhe ndëshkimet është 180,710.71 euro. Tutje ekspertët kanë dhënë konstatim se disa nga vlerat e librave të blerjeve përputhen me vlerat e librave të ekzaminuara nga ri kontrolli tatimor, e disa të tjera jo e që sipas viteve janë sikur në vijim; për vitin 2008 nga 5 libra të prezantuara vetëm për muajin 7 vlera janë të njëjta ndërsa për muajt 8,10,11 dhe 12 vlerat ndryshojnë, për vitin 2009 janë prezantuar 3 lira për muajt 1,9 dhe 11 dhe vlera e tyre përputhen me ato të librave me kontroll; për vitin 2010 janë prezantuar 4 libra

dhe atë për muajt 5 dhe 11 me vlera të njëjta ndërsa për muajt 9 dhe 12 ndryshojnë; për vitin 2011 janë prezantuar 5 libra dhe atë për muajt 5 dhe 9 me vlera të njëjta ndërsa për muajt 10, 11 dhe 12 me vlera që ndryshojnë dhe për vitin 2012 janë prezantuar 3 libra për muajt 4,9 dhe 10 me vlera të njëjta si gjatë kontrollit. Grupi i ekspertëve i ka trajtuar një nga një faturat dhe ka konstatuar se ato fatura janë marrë parasysht nga ri kontrolli tatimor si blerje por janë përfshirë edhe në librat e shitjeve me arsyetimin se tatimpaguesi nuk ka dëshmuar se ato blerje janë përfshirë në aktivitetin ekonomik për destinimin për të cilin janë blerë.

Gjykata ekspertizës financiare dhe plotësimit të saj, nuk i'a ka falur besimin e plotë, kjo për faktin se mendimi dhe konstatimi i dhënë në super ekspertizën e lartcekur në raport me plotësimin e saj si dhe sqarimeve të paraqitura nga eksperti financiar në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 07.02.2024, janë në kontradiktë njëra me tjetrën, pra nuk kanë një konsistencë në raport me gjendjen faktike të cilën duhet vërtetuar.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave materiale të cilat i kemi elaboruar me lartë, mendimit të grupit të eksperteve, Gjykata edhe përkundër faktit se në këtë çështje është nxjerr prova me ekspertizë financiare, konstaton se ky kontest tregtar administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, andaj edhe anulohet vendimi kontestues i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, tek e paditura e cila obligohet që të vlerësoj të gjitha provat e trajtuara në këtë kontest gjyqësor, respektivisht faturat, kuponët dhe fletë dërgesat me subjektet përkatëse.

E paditura në rivendosje duhet të përcaktoj vendimmarrje të qartë në dispozitiv, duke saktësuar se çka ka Aprovuar pjesërisht dhe çka ka refuzuar në mënyrë që nga kjo, pastaj Gjykata të këtë mundësi të shqyrtoj ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së.

E paditura të vlerësoj flete dërgesat e karburanteve për vitin 2008 sipas evidencës se bashkangjitur në plotësimin e dytë të super ekspertizës financiare, fletë dërgesat e këtu paditësi me subjektin "Kema company" dhe fletë dërgesat dhe kuponët e këtu paditësit me subjektin "Standart Benz", së bashku me tabelat e shitjeve, dokumente këto të trajtuara me plotësim të

super ekspertizës dhe për të cilat pala paditëse pretendon se nuk janë trajtuar si të tilla nga e paditura në procedurë administrative, dhe vetëm sipas kësaj dhe mbi bazën e këtyre verifikimeve të japë vlerësim të drejtë në kuptim të obligimeve eventuale lidhur me tatimin për këtu paditësin, dhe varësisht nga gjetjet dhe rezultatet të ndryshojë edhe gjobat eventuale.

E paditura në rivendosje duhet të verifikoj edhe njëherë të gjitha faturat, kuponët, dhe fletë dërgesat duke vlerësuar në ri procedurë edhe të gjeturat nga ekspertiza financiare e datës 11.04.2019, super ekspertiza financiare e datës 13.11.2019 dhe plotësimet e super ekspertizave financiare të datës 26.02.2020, dhe 05.01.2024, dhe vetëm pastaj dhe mbi bazën e kësaj të nxjerrë konstatim vetëm për ato qarkullime me efekt të sakt në tatim.

Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë lëndë të kontestit tregtar - administrativ nuk ka mundur të vërtetohet saktë dhe në tërësi gjendja faktike, andaj edhe është vepruar komfor nenin 43 par 2 të LKA-së, ku thuhet se : *“Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ”*.

Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë kontest tregtar administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon kërkesëpadinë e paditësit, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, edhe duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Bazuar në nenin 7 paragrafi 1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla, Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat, lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen”*. Nga këto dispozita gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit nenit 43 par 1 dhe 2, dhe 46 par. 1 dhe 3 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.970/22 datë 07.02.2024

Zyrtare Ligjore,
Amire Jahiri

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.